



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KOMISIONI I KONKURENCËS

**VENDIM**

**Nr. 632, Datë 20.06.2019**

**“Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 607, datë 01.04.2019 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit””**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.06.2019, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 607, datë 01.04.2019 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit”.

**Baza Ligjore:** Neni 24 gërma, (d) dhe neni 43 pika 3 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

**VËREN SE :**

Në pikën “2” të dispozitivit të Vendimit Nr. 607, datë 01.04.2019 të Komisionit të Konkurrencës duhet të bëhet ndryshimi për zgjatjen e afatit si vijon: *Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.01.2015 deri në 30.04.2019.*

**PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, gërma (d) dhe nenin 43 pika 3 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

**VENDOSI:**

1. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 607, datë 01.04.2019 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit”, pika “2” të ndryshohet si vijon:

*“2. Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.01.2015 deri në 30.04.2019.”.*

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURENCËS**